



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:099136

Datë: 11.01.2024

Numri i dokumentit: 05178800

PA1.nr.1545/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Pergjithshem, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Ferit Osmani, anëtarë, me praktikantin gjyqesor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarit D.T., nga fshati ...– Komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-se dhe veprës penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-se, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtësit se të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan P.nr.299/2023 të datës 09.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 04 Janar 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.T., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan P.nr.299/2023 i datës 09.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan P.nr.299/2023 të datës 09.10.2023, i akuzuari D.T., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-se, për të cilën i është shqiptuar denimi me gjobe në shumë prej 500 (pesëqind) euro si dhe veprën penale sulmi nga neni 184 paragrafi 1 të KPRK-se për të cilën i është shqiptuar denimi me gjobe në shumë prej 200 (dyqind) euro, e në pajtim me nenin 76 të KPRK-se i është shqiptuar denimi unik në shumë prej 700 (shtatëqind) euro, e të cilën gjobe është obliguar që ta paguaje në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerisë së aktgjykimit, në të kundërtën

denimi i shqiptuar me gjobe do të i zevendesohet në denim me burgim ku për çdo 20 euro të gjobes do të i llogaritet 1 ditë burgim.

Gjithashtu, të akuzuarit i është shqiptuar edhe denimi plotësues, ku i është konfiskuar arma e tipit bereta me afër e përshkruar në faqen 2 të aktgjykimit të ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë.

I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogaritës së fundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 (nëzet) euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20 (nëzet) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerisë së aktgjykimit.

I demtuari E.G., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankese ka ushtruar :

Mbrojtësi i të akuzuarit D.T. – Av.Fidan Ibrahimit nga Lipjani, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, dhe të akuzuarit për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor të i shqiptohet dënimi dukshëm më i ulët me gjobe se sa denimi i shqiptuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, të lirohet nga përgjegjësia penale apo që denimi i shqiptuar të i kushtëzohet, e me të cilin dënimi do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së.

Prokurori i Apelit të Kosovës, duke u shkëputur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit D.T., me shkresën e vet PPA.II.nr. 1579/2023 të datës 06.12.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit të Kosovës, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë të vertetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-së, për të cilën nuk i ftoi palët në rastin konkret kemi të bëjmë me denim me gjobe dhe pretendimet ankimore janë vetëm lidhur me sanksionin penal andaj prezencës e paleve nuk është e obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, dhe gjeti se:

- Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të Kosovës të njëjtin e shqyrtoi në këtë aspekt sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 të KPPRK-së dhe konstatoi se nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e as shkelje të ligjit penal e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 09.10.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari, pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij. Pranimi i fajësisë ka mbështetur në faktet

që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit D.T. – Av.Fidan Ibrahim, me ankesë pretendon se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të denimit unik me gjobe, nuk i ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të duhur rrethanat lehtësuese si faktin se i akuzuari në fazat e hershme të procedurës e ka pranuar fajësinë për veprat penale të kryera, ka shprehur keqardhje, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, se me parë nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, se i është gjendur se varfer ekonomike, pastaj se ka qenë i provokuar nga i demtuari, e sikur këto rrethana të ishin vlerësuar në mënyrë të duhur është dashur që të akuzuarit të i shqiptohet një denim dukeshëm me i ulet se sa denimi i shqiptuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë apo që i njëjti të i kushtëzohet, e me të cilin denim do të arrihej qëllimi i denimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së, andaj ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me sanksionin penal të mbrojtësit të akuzuarit për shqiptimin e denimit me të ulet me gjobe apo denim të kushtëzuar, dhe pas vlerësimit të njëjtes, dhe duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret, Gjykata e Apelit konstaton se Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se denimi unik i shqiptuar me gjobe ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera, andaj e refuzoi si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, duke e vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë, e me bindje se me denimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1545/23 më 04.01.2024

Procesmbajtësi
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Skender Çoçaj

Ferit Osmani
